

VENDIM
Nr. 658, datë 31.10.2018

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË PASURISË SË PALUAJTSHME
“TRUALL”, NË ZONËN KADASTRALE 8602, ME NUMËR PASURIE 2/149, TE
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË,
PËR UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 8, 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të pasurisë së paluajtshme “truall”, në zonën kadastrale 8602, me numër pasurie 2/149, e regjistruar në volumn 46, faqe 97, me sipërfaqe 6301 (gjashtë mijë e treqind e një) m², pronë shtet, te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme.

2. Pasuria e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi, të përdoret në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pasurisë së paluajtshme, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë dhe Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
 ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME VLORE
 Adresa: Rruga Il Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

VLORE, me 24 / 7 / 2018

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 46, Faqe 97, Zona Kadastrale 8602, Qyteti Vlorë

